

## KONTRATE PER SHITJE KUOTASH

Ne Tirane, sot me 6 dhjetor 2021, palet e meposhtme kane lidhur kete kontrate per shitjen e Kuotes (me poshte "Kontrata"):

**SMARTWORK SHPK**, shoqeri e organizuar dhe qe ushtron veprimtarine sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, e regjistruar ne regjistrin tregtar qe mbahet nga Qendra Kombetare e Biznesit, me numer unik te regjistrimit te biznesit (NUIS) L71928020R me seli ne adresen Rruga "Jordan Misja", Kompleksi "USLUGA", Kati 2, Tirane, Shqiperi. (ne vijim "Smartwork");


**GJERGJI ROBO**, shtetas shqiptar, i datelindjes 18.05.1984, mbajtes i ID-se me numer personal 1405518067I (ne vijim "GR", dhe se bashku me Smartwork, ne vijim "Shitesit")

dhe

**TEAMSYSTEM S.p.A.**, shoqeri aksionare, e organizuar dhe qe ushtron veprimtarine sipas legjislacionit te Republikes se Italise, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar te Pesaros dhe Urbinos me nr. 1035310414, me seli ne adresen Via Sandro Pertini 88, Pesaro, Itali (ne vijim "Bleresi").

### MEQENESE:

- (A) Shitesit jane zoterues te Kuotave ne kapitalin e shoqerise UNITSYSTEM SHPK (ne vijim "Shoqeria"), e cila eshte organizuar dhe ushtron veprimtarine sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, me seli ne Rruga Jordan Misja, Kompleksi USLUGA, Kati 2, Tirane, e regjistruar ne regjistrin tregtar qe mbahet nga Qendra Kombetare e Biznesit me nr. M12402020H, me kapital ne vleren 10.000 Leke (ne vijim "Kapitali"), specifikisht:
- Smartwork eshte zoterues i nje Kuote, ne vleren 7.000 Leke, qe perben 70% ne Kapitalin e Shoqerise;
  - GR zoterues i nje Kuote, ne vleren 3.000 Leke, qe perben 30% ne Kapitalin e Shoqerise.
- (B) Secili nga Shitesit ka rene dakord t'i shese Bleresit dhe Bleresi ka rene dakord te bleje nga secili prej Shitesve, nje pjese nga Kuota e tyre, ne vleren prej 100 Leke, qe ne total perben 1 kuote ne vleren 200 Leke dhe qe ne total perkon me 2% te Kapitalit te Shoqerise.

  
Viktorie Spah  
Spah



Per sa me lart, palet bien dakord per sa me poshte vijon:

## NENI 1


### TRANSFERIMI I KUOTES

- 1.1 Ne baze te kushteve dhe afateve te cituara ne kete Kontrate, Secili nga Shitesit ka rene dakord t'i shese Bleresit dhe Bleresi ka rene dakord te bleje nga secili prej Shitesve, nje pjese nga Kuota e tyre, ne vleren prej 100 Leke, qe ne total perben 1 kuote ne vleren 200 Leke dhe qe ne total perkon me 2% te Kapitalit te Shoqerise.
- 1.2 Pas transferimit te Kuotave nga Shitesat tek Bleresi, Kapitali i Shoqerise do te zoterohet ne pjeset e meposhtme:
- (i) Bleresi do te zoteroje 1 Kuote, ne vleren 200 Leke, qe perkon me 2% ne Kapitalin e Shoqerise;
  - (ii) Smartwork do te zoteroje 1 Kuote, ne vleren 6900 Leke, qe perkon me 69% ne kapitalin e Shoqerise;
  - (iii) GR do te zoteroje 1 Kuote, ne vleren 2900 Leke, qe perkon me 29% ne kapitalin e Shoqerise.
- 1.3 Shitesit angazhohen kundrejt Bleresit si me poshte vijon:
- (i) Shitesit kane te drejte te shesin dhe te transferojne titullin e pronesise se Kuotave te tyre respektive ne perputhje me kete Kontrate; dhe
  - (ii) ne ose pas dates se transferimit te Kuotave, Shitesit do te kryejne/permbushin me shpenzimet e tyre te gjitha dokumentet aktet dhe çdo veprim tjeter te nevojshem per te transferuar Kuoten ne emer te Bleresit.

Kuota shitet e lire nga çdo barre/peng apo te drejta te tjera te te paleve te treta. Titulli i pronesise se Kuotes do te transferohet nga Shitesit te Bleresi me nenshkrimin e kesaj Kontrate.

## NENI 2

### ÇMIMI I SHITJES



Viktoria Grm



- 2.1 Me nenshkrimin e kesaj Kontrate, Palet deklarojne dhe pranojne se Bleresi, u ka paguar secilit prej Shitesve, shumen 100 Leke, ne total shumen 200 Leke (ne vijim "Çmimi i Shitjes").

### **NENI 3**

#### **DEKLARIMET DHE GARANCI**

- 3.1 Shitesit deklarojne dhe garantojne se: (i) Shitesit jane pronare te Kuotes siç eshte permendur edhe ne paragrafin (A) ne hyrjen e kesaj Kontrate; (ii) Shitesit kane nenshkruar dhe shlyer teresisht Kuoten; (iii) Kuota e tyre objekt i kesaj Kontrate eshte e lire nga çdo barre/peng si dhe nga çdo e drejte apo pretendim tjetër i te treteve; (iv) kjo Kontrate perben detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem dhe te ekzekutueshem per Shitesit.
- 3.2 Bleresi deklaron dhe garanton Shitesit se:
- (a) ka fuqine dhe kompetencen te lidhe, te nenshkruaja dhe te zbatoje kete Kontrate;
  - (b) ka marre te gjitha autorizimet (nese duhen te tilla) per nenshkrimin dhe zbatimin e kesaj Kontrate; dhe,
  - (c) kjo Kontrate perben nje detyrim te ligjshem dhe te ekzekutueshem ndaj Bleresit dhe lidhja e kesaj Kontrate e zbatimi i saj ne perputhje me kushtet e saj nuk do te:
    - (i) rezultojne ne kundershtrim me ndonje parashikim te ndonje ligji te aplikueshem ndaj Bleresit apo ndonje Kontrate nderkombetare te zbatueshme ndaj Bleresit;
    - (ii) bjere ne kundershtrim ose do te perbeje mospermbushje te ndonje prej parashikimeve, ose kerkoje miratim sipas kushteve te ndonje Kontrate ne te cilen Bleresi eshte pale; ose
    - (iii) perbeje nje mospermbushje sipas ndonje Kontrate.

### **NENI 4**

#### **TE NDRYSHME**

- 4.1 Palet bien dakord qe me zbatimin e kesaj Kontrate, Statuti i Shoqerise do te ndryshohet dhe Statuti i bashkengjitur ne Aneksin 1 te kesaj Kontrate do te miratohet dhe do te zevendesojë Statutin ne fuqi.
- 4.2 Kjo Kontrate eshte negociuar dhe hartuar ne gjuhen angleze. Nese kerkohet reference per perkthimin ne nje gjuhe tjetër, çdo paqartesi ne tekstin e nje perkthimi te tille ne nje gjuhe

Viktorina Spence  
Spence



tjeter ose çdo mosmarveshje ne lidhje me perkthimin ne nje gjuhe tjeter do te zgjidhet duke iu referuar tekstit anglisht te kesaj Kontrate.


## NENI 5

### LIGJI I ZBATUESHEM DHE ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE


- 5.1 Per çfare nuk eshte parashikuar ne kete Kontrate apo qe mund te rrjedhe prej saj do zbatohet legjislacioni perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise i cili eshte ligji i zbatueshem per kete Kontrate.
- 5.2 Nese lind ndonje mosmarveshje nga interpretimi dhe zbatimi i kesaj Kontrate, Palet fillimisht do te perpiqen ta zgjidhin kete mosmarveshje nepermjet negociatave miqesore.
- 5.3 Nese nje mosmarveshje e tille nuk zgjidhet me negociata, secila pale mund ta paraqese kete mosmarveshje prane Gjykates se Rrethit Tirane, Shqiperi.

PER SA ME SIPER, Palet nenshkruajne si me poshte:


Smartwork  
ANDREA RUSCICA  
Administrator



Gjergji Robo

Gjergji Robo 

TeamSystem S.p.A.  
TOMMASO GIOVANNI COHEN



Victorie Spin  
